

Vendim nr. 227 datë 22.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 22.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 35 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ALMA SAITI, përfaqësuar nga avokat Envi Hicka, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 918, datë 20.04.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-673, datë 12.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Urdhërimi i Gjykatës së Apelit Tiranë për përsëritjen e gjykimit.
Konstatimi i cenimit të së drejtës për gëzimin e qetë të pronës në kuadër të shkeljes të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 49, 50 e 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është një nga trashëgimtarët ligjorë të babait të saj A.Sh., i cili ka ndërruar jetë në vitin 2001. Trashëgimtarët e këtij të fundit, bashkëshortja dhe 3 fëmijët, janë përfshirë në një mosmarrëveshje me vëllanë e tij, shtetasin K.Sh., në lidhje me pasurinë banesë 1-katëshe, të përbërë nga dy dhoma e korridor, me oborr, të ndodhur në Tiranë. Kjo pasuri, në origjinë, ka qenë pjesë e pasurisë trashëgimore të shtetasit I.P., një nga trashëgimtarët e të cilit ka qenë edhe shtetasja B.P., që është motra e shtetasit S.Sh., ndërsa ky i fundit është babai i A.Sh. (trashëgimlënësi i kërkueses) dhe K.Sh. Pasuria në fjalë (banesa me oborr), pas pjesëtimit vullnetar të pasurisë mes trashëgimtarëve të I.P. në vitin 1950, i është lënë në pronësi B.P. dhe ky pjesëtim është vërtetuar me vendimin nr. 1816, datë 26.10.1968 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në bazë të së cilit pasuria në vijim është regjistruar në pronësi të B.P. në regjistrimin hipotekor nr. 186, datë 07.11.1968.

2. Pasurinë objekt mosmarrëveshje, pasi është pajisur me lejen nr. 15, datë 03.12.1968 nga Komiteti Ekzekutiv (Këshilli Popullor i lagjes nr. 3), me kontratën noteriale të dhurimit nr. 33422/15060, datë 10.12.1968 (*kontrata e dhurimit*), B.P. ia ka dhuruar nipit K.Sh., nisur nga ndjenja për t'i bërë mirë, në kushtet kur ai kishte nevojë të domosdoshme për banesë. Kontrata e dhurimit është regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. 198, datë 14.12.1968 dhe K.Sh. ka banuar në atë banesë në vazhdimësi, ndërkohë që B.P. ka ndërruar jetë në datën 14.10.1980. Në vijim, mbi padinë e K.Sh., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5063, datë 18.12.2002, ka vendosur korrigjimin e regjistrimit për sipërfaqen e truallit në 544 m², ndërsa me kontratën e sipërmarrjes nr. 2046/317 kol., datë 04.11.2006 (*kontrata e sipërmarrjes*), K.Sh. ka vënë në dispozicion të shoqërisë "T." sh.p.k. truallin për ndërtimin e një godine 7+2 kate, në këmbim të së cilës do të përfitonte 6 apartamente.

3. Në datën 17.10.2013 trashëgimtarët e A.Sh., konkretisht bashkëshortja M.Sh. dhe fëmijët E.Sh.(L.) dhe A.Sh.(I.), me pretendimin se janë trashëgimtare të së ndjerës B.P., ndërsa trashëgimlënësi i tyre, krahas K.Sh., është përcaktuar si trashëgimtarë ligjor i saj me vendimin nr. 4237, datë 09.12.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, në bazë të nenit 349 e vijues të Kodit Civil (KC), duke kërkuar, sipas objektit të saktësuar të saj, detyrimin e K.Sh. t'i njohë trashëgimtarë të B.P., në 1/2 pjesë, mbi pasuritë e përfituara në bazë të kontratës së sipërmarrjes, për shkak të pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit, pasi ajo është hartuar në kundërshtim me dekretin nr. 2821, datë

22.12.1958 “Mbi noterinë” (dekreti nr. 2821/1958). Me vendimin nr. 10775, datë 10.11.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se padia është ngritur kundër një personi që nuk legjitimohet pasivisht në padinë për kërkimin e trashëgimit sipas nenit 349 e vijues të KC-së, pavarësisht nëse kontrata e dhurimit është ose jo e pavlefshme, për më tepër kur kjo kontratë nuk është e pavlefshme. Kundër këtij vendimi paditëset kanë paraqitur ankim.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 918, datë 20.04.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në mënyrë të përmbledhur, gjykata e apelit ka arsyetuar se paditëset legjitimoheshin në ngritjen e padisë, pasi në rast pavlefshmërie absolute të kontratës së dhurimit ato mund të pretendonin të drejta trashëgimie mbi pasurinë objekt konflikti, sikundër dhe i padituri legjitimohej pasivisht për sa kohë ai do të ishte në kushtet e mbajtjes së një pasurie trashëgimore. Megjithatë, vijon ajo, sikurse edhe gjykata e shkallës së parë kishte konkluduar, paditësit nuk provojnë që kontrata e dhurimit është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm. Kundër këtij vendimi paditëset kanë paraqitur rekurs.

5. Ndërsa çështja ndodhej në Gjykatën e Lartë, paditësja M.Sh. ka ndërruar jetë, shkak për të cilin ajo është zëvendësuar edhe nga kërkuesja. Në vijim, me vendimin nr. 00-2025-673, datë 12.02.2025, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbush kërkesat e nenit 472 të KPC-së, sipas përmbajtjes në kohën e paraqitjes së tij.

6. Në datën 27.06.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjyjkata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

7. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e faktit nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paditëseve se kontrata e dhurimit është hartuar në kundërshtim me nenet 18, 22 dhe 40 të dekretit nr. 2812/1958. Edhe pse në gjykim ishin paraqitur dokumente të nënshkruara nga B.P., gjykatat nuk i kanë marrë në konsideratë këto akte dhe nuk kanë përcaktuar nëse ajo dinte shkrim e këndim. Po kështu, ato nuk kanë përcaktuar nëse shtesa e bërë me shkrim dore se B.P. nuk dinte shkrim

plotësonte kërkesat formale të nenit 18 të dekretit nr. 2812/1958 dhe nëse është verifikuar identiteti i shtetasit që ka nënshkruar në emër të B.P. dhe nëse nënshkrimi i tij është vërtetuar, përveçse ato nuk kanë bërë interpretim të normave ligjore në kuadër të problemeve juridike të ngritura. Vendimet e gjykatave të faktit janë riprodhime të njëri-tjetrit. Edhe Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për çështjet juridike të ngritura në rekurs në lidhje me zbatimin e dispozitave të dekretit në fjalë.

7.1.2. *Së drejtës për t'u njoftuar për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë*, pasi edhe pse kjo gjykatë ka pasur në dispozicion të dhënat e përfaqësuesit të paditëseve, nuk e ka njoftuar atë për vendimmarrjen e saj, duke bërë që kërkesja të kishte më pak se 5 ditë për përgatitjen e ankimit kushtetues individual. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i saj ka qenë i mundur për aksesim që në datën 28.02.2025, por megjithatë një fakt i tillë është i pamundur të provohet.

7.2. *E drejta e pronës*, pasi prona objekt mosmarrëveshjeje është pasuri trashëgimore e B.P. dhe ajo u kalon në mënyrë të barabartë trashëgimtarëve A.Sh. dhe K.Sh, për sa kohë kontrata e dhurimit është e pavlefshme, pasi ajo është hartuar në kundërshtim me kërkesat formale të ligjit, dekretit të kohës për noterinë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuësës

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshtëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor në rastin konkret mban datën 12.02.2025 dhe, sipas informacionit të kësaj gjykate të vënë në dispozicion të kërkueses, është publikuar në faqen e saj zyrtare më 28.02.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 27.06.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuesja ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* e *së drejtës për t’u njoftuar për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë*, si dhe *së drejtës së pronës*, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

13. Kolegji vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t’u njoftuar për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë*, me argumentin se mosnjoftimi i asaj vendimmarrjeje në adresën e përfaqësuesit të paditëseve edhe pse ka pasur në dispozicion të dhënat përkatëse, ka kufizuar kohën për përgatitjen dhe paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Kolegji vëren se Gjykata e Lartë nuk ia ka njoftuar vendimin e saj të arsyetuar përfaqësuesit të paditëseve, ndonëse në dosjen gjyqësore ka qenë e depozituar adresa e tij, përfshirë edhe ajo elektronike. Megjithatë, sikurse pranohet nga kërkuesja, pas kërkesës së paraqitur, vendimi i është vënë në dispozicion përfaqësuesit të saj nga sekretaria e asaj gjykate dhe kërkuesja në vijim ka depozituar ankimin kushtetues individual. Nisur nga kjo, edhe pse konstatohen parregullsi në lidhje me njoftimin e vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Lartë, për sa kohë kërkueses në vijim i është njoftuar efektivisht ai vendim dhe ajo ka ushtruar të drejtën e ankimit kushtetues individual, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë në aspektin kushtetues

pasojat reale dhe konkrete të ardhura si rrjedhojë e asaj mënyre njoftimi nga Gjykata e Lartë të vendimmarrjes së saj. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Për sa u përket pretendimeve të tjera, duke pasur parasysh argumentet në thelb të kërkueses, Kolegji çmon t'i analizojë ato në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit substancial dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës

15. Kërkuësja ka pretenduar se gjykatat e faktit nuk kanë marrë parasysh pretendimet se kontrata e dhurimit është hartuar në kundërshtim me nenet 18, 22 dhe 40 të dekretit nr. 2812/1958. Edhe pse në gjykim ishin paraqitur dokumente të nënshkruara nga B.P., gjykatat, sipas saj, nuk kanë marrë në konsideratë këto akte dhe nuk kanë përcaktuar nëse ajo dinte shkrim e këndim. Po kështu, ato nuk kanë përcaktuar nëse shtesa e bërë me shkrim dore se kjo shtetase nuk dinte shkrim e këndim plotësonte kërkesat formale të nenit 18 të dekretit nr. 2812/1958 dhe nëse është verifikuar identiteti i shtetasit që ka nënshkruar në emër të B.P. dhe nëse nënshkrimi i tij është vërtetuar, përveçse ato nuk kanë bërë interpretim të normave ligjore në kuadër të problemeve juridike të ngritura. Vendimet e gjykatave të faktit janë riprodhime të njëri-tjetrit. Po sipas kërkueses, edhe Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për çështjet juridike të ngritura në rekurs në lidhje me zbatimin e dispozitave të dekretit në fjalë. Si rrjedhojë e këtyre shkeljeve, gjykatat i kanë cenuar edhe të drejtën e pronës së rrjedhur nga trashëgimia.

16. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon edhe se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, por edhe të drejtën për të pasur nga ajo një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 32, datë 19.05.2025; nr. 41, datë 29.05.2024; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata është shprehur se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre, në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda

vendimit. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të tij (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pohuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po kështu, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa i përket së drejtës për pronë private, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ajo përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike dhe se kjo e drejtë, në çdo rast, shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin (*shih vendimet nr. 32, datë 19.05.2025; nr. 31, datë 18.04.2024; nr. 53, datë 31.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se nëna e ndjerë e kërkueses dhe dy motrat e saj kanë vënë në lëvizje procesin gjyqësor të kundërshtuar përmes një padie për kërkimin e trashëgimit, bazuar në nenet 349 e vijues të KC-së, me pretendimin se pasuria objekt mosmarrëveshjeje është pasuri trashëgimore e së ndjerës B.P., trashëgimtar i të cilës, për ½-ën pjesë të pasurisë së saj, është edhe nipi i saj, trashëgimlënësi i tyre A.Sh. Sipas tyre, veprimi juridik për kalimin e pronësisë të kësaj pasurie në favor të nipit tjetër të saj, të paditurit K.Sh., kontrata e dhurimit, është absolutisht i pavlefshëm, pasi në kontratë mungonte vullneti i dhurueses B.P. dhe kontrata ishte hartuar në kundërshtim me nenet 16, 18 dhe 22 të dekretit nr. 2821/1958, në rrethanat kur noteri nuk kishte vërtetuar identitetin e personave që merrnin pjesë në akt, duke mos shënuar dokumentet përkatëse të identifikimit të tyre dhe fakti se dhuruesja

nuk dinte shkrim dhe këndim është bërë me një shënim me shkrim dore, i cili ishte i ngjashëm me nënshkrimin e shtetasit H.D në rubrikën “dhuruesja B.P.”, por nuk tregohet se ai është ngarkuar nga dhuruesja për nënshkrimin e kontratës në emër të saj, përveçse kontrata nuk përmban as shenjën e gishtit të dhurueses.

21. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se ajo nuk plotëson kushtin e kërkuar nga neni 349 e vijues të KC-së, pasi është ngritur kundër një personi, i cili nuk e ka mbajtur dhe as e mban pasurinë si trashëgimtar i B.P., por në bazë të kontratës së dhurimit, ndaj i padituri nuk u ka mohuar paditëseve cilësinë e tyre si trashëgimtare të B.P., duke mos u legjitimuar ai pasivisht në padinë për kërkimin e trashëgimit të ngritur kundër tij, përfundim i cili vlen edhe në supozimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit dhe mbajtjes nga i padituri të pasurisë pa asnjë titull. Pavarësisht kësaj, kontrata e dhurimit nuk është e pavlefshme, pasi, ndryshe nga sa pretendohet, ajo përmban elementet formale të kërkuara nga ligji i kohës. Sipas asaj gjykate, neni 16 i dekretit nr. 2812/1958 detyron noterin të vërtetojë identitetin e personave që marrin pjesë në akt me anë të (pasaportës) letërnjoftimit, por nuk kërkon në mënyrë të shprehur shënimin në akt të këtij dokumenti (numrat referues), ndërkohë që në rastin konkret noteri ka identifikuar në mënyrë të plotë personat në kontratën e dhurimit, duke evidentuar se për identitetin e tyre është siguruar në pajtim me ligjin. Po sipas gjykatës, shënimi me shkrim dore në fund të kontratës, nuk ka të bëjë me ndonjë ndërhyrje në përmbajtjen e saj në kuptim të nenit 18 të dekretit në fjalë, pra për sa i përket objektit dhe kushteve të saj. Në lidhje me faktin se dhuruesja nuk dinte shkrim, vijon gjykata, në mungesë të çdo prove të kundërt dhe nisur nga përmbajtja e kontratës e shënimi i bërë në të, arrihet në përfundimin se ajo nuk ka ditur të shkruajë. Sipas gjykatës, shënimi se “Meqë B.P. nuk di shkrim, delegon për firmë H.D., banues në Tiranë”, tregon më së miri faktin se B.P. nuk dinte shkrim, ndaj në harmoni me këtë, në vijim të këtij shënimi, në pjesën e fundit të kontratës, në rubrikën “Dhuruesja B.P.”, është nënshkrimi i plotë i shtetasit H.D., duke u plotësuar kështu kërkesat e nenit 22 të dekretit, i cili, nga ana tjetër, nuk ka ndonjë përcaktim/kushtëzim për rrethin e personave që mund të ngarkohen për nënshkrim të aktit noterial. Gjithashtu, sipas gjykatës, dekreti nuk përcakton asnjë detyrim për marrjen e gjurmës së gishtit të personave që nuk dinë shkrim.

22. Përveç sa më lart, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kopja e kontratës së dhurimit e paraqitur si provë në gjykim është e njëjtë me kopjen e ndodhur në Arkivën e Shtetit. Po sipas saj, përmbajtja e kontratës është në harmoni me lejen e dhurimit të dhënë nga organi publik sipas ligjit të kohës dhe vlefshmëria e saj nuk është vënë asnjëherë në diskutim për 45 vjet, deri në ngritjen e padisë në shqyrtim, si nga trashëgimtari i drejtpërdrejtë i B.P. (vëllai

S.Sh., i vdekur në vitin 1990), ashtu dhe nga ai me zëvendësim (djali i vëllait, trashëgimlënësi A.Sh. i paditësve, i vdekur në vitin 2001), të cilët nuk kanë ngritur ndonjëherë pretendime për pronën objekt gjykimi.

23. Çështja është shqyrtuar në vijim nga gjykata e apelit, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nga ana e saj, gjykata e apelit ka arsyetuar se paditëset legjitimohen në ngritjen e padisë, pasi nëse do të konstatohej pavlefshmëria absolute e kontratës së dhurimit, pasuria objekt material gjykimi do të përbënte automatikisht pasuri trashëgimore të trashëgimlënëses B.P., nga e cila do të përfitonin edhe ato si trashëgimtare ligjore dhe i padituri K.Sh. do të legjitimohej pasivisht, pasi do të ishte ligjërish në kushtet e mbajtjes së pasurisë trashëgimore objekt kërkimi. Megjithatë, sipas saj, sikurse edhe gjykata e shkallës së parë ka konkluduar, paditësit nuk provojnë që kontrata e dhurimit është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm. Në përgjigje të pretendimit të ngritur për pavërtetësinë e faktit se dhuruesja B.P. nuk dinte shkrim e këndim, duke iu referuar një “prokure noteriale” të datës 25.05.1968 dhe një kërkesë të datës 21.11.1968 drejtuar Zyrës së Hipotekës Tiranë, akte të cilat, sipas paditësve, ishin nënshkruar nga B.P., gjykata e apelit ka arsyetuar se akti i redaktuar nga noteri, siç është edhe kontrata e dhurimit në rastin për gjykim, përbën një akt zyrtar me fuqi të plotë provuese, i cili mund të kundërshtohet vetëm për falsitet, çka nuk rezulton të ketë ndodhur në rastin për gjykim.

24. Po ashtu, çështja i është nënshtruar edhe kontrollit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit të paditëseve me arsyetimin se ai nuk përmbush kërkesat e nenit 472 të KPC-së, sipas përmbajtjes në kohën e paraqitjes së tij, pasi në të nuk parashtrohej asnjë argument i qenësishëm që të lidhet me një nga shkaqet për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit sipas kësaj dispozite, ndërkohë që pretendimet që kishin të bënin me vlerësimin e provave dhe fakteve, dilnin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të Gjykatës së Lartë.

25. Referuar standardeve kushtetuese të mësipërme, Kolegji vëren se vendimet gjyqësore objekt kërkesë përmbushin këto standarde. Vendimet e gjykatave përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe faktet e pranuar, ligjin e zbatueshëm dhe analizën e tij në kontekst të rrethana të rastit konkret. Gjykatat e faktit kanë analizuar dhe i kthyer përgjigje çdo pretendimi të parashtruar në padi, gjatë gjykimit dhe në ankim, si për sa u përket fakteve, ashtu dhe në lidhje me zbatimin e ligjit. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, tregon vendimmarrjen e gjykatave të faktit, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar,

Gjykata e Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në nenin 472 të KPC-së.

26. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se argumentet e paraqitura nga kërkuesja për të drejtat e pretenduara si të cenuara, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e të zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë mbajtur të njëjtin qëndrim, si për sa i përket përcaktimit të fakteve me rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ashtu edhe për interpretimin dhe zbatimin e ligjit për sa i përket (pa)vlefshmërisë së kontratës së dhurimit dhe (mos)përfshirjes së pasurisë objekt konflikti në rrethin e pasurisë trashëgimore të B.P., nga derivonte dhe e drejta e trashëgimisë e pretenduar edhe nga kërkuesja. Në veçanti, gjykatat e faktit kanë analizuar dhe i kanë kthyer përgjigje pretendimit se, në mungesë të provave të kundërta, nuk provohej fakti se dhuruesja B.P. dinte shkrim dhe se pavërtetësia e pretenduar e këtij fakti të pasqyruar në një akt zyrtar me fuqi të plotë provuese, siç ishte kontrata noteriale e dhurimit, mund të kundërshtohej vetëm për falsitet, gjë e cila nuk ka ndodhur në këtë rast. Në këtë drejtim, vlen të evidentohet se, ndryshe nga sa pretendohet nga kërkuesja, në dosjen gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi nuk gjendet e administruar si provë dokumenti “prokurë noteriale” i datës 25.05.1968 dhe as kërkuesja nuk duket se ka paraqitur ndonjë argument konkret për sa pretendon në kërkesën drejtuar Gjykatës. Prokura në fjalë përmendet në vendimin nr. 1816, datë 26.10.1968 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për vërtetimin e faktit të pjesëtimit vullnetar të pasurisë trashëgimore të I.P., proces gjyqësor, i cili, referuar përmbajtjes së vendimit në fjalë, është vënë në lëvizje nga B.P., e cila është përfaqësuar nga vëllai i saj S.Sh. në bazë të prokurës në fjalë, ndërkohë që kërkesa e datës 21.11.1968 drejtuar Zyrës së Hipotekës Tiranë ka të bëjë pikërisht me regjistrimin e këtij vendimi gjyqësor.

27. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme është arbitrar në kuptimin që gabimi faktik ose ligjor i tyre të jetë aq i dukshëm sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë.

28. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit substancial dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.